



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 1 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe nenet 36(1) dhe (2) dhe (41) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),² nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 16 nëntor 2021, Mbrojtja e z. Hashim Thaçi (“Mbrojtja” dhe “z. Thaçi”) dorëzoi parashtrimet e saj lidhur me rishikimin periodik të paraburgimit të z. Thaçi (“Kërkesa”).³
2. Më 29 nëntor 2021, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës (“Përgjigjja”).⁴
3. Më 1 dhjetor 2021, Mbrojtja dorëzoi një kërkesë bazuar në nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për shtimin deri në 6.000 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e saj të ardhshme (“Kërkesa për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”).⁵ Sipas Mbrojtjes, ndryshimi i kërkuar për ligjet nga rrethana të posaçme, ku hyjnë rëndësia e tematikës së kundërpërgjigjes, konkretisht liria e të akuzuarit, risia e argumenteve të ZPS-së dhe sasia e materialeve publike të cilave u referohet ZPS-ja në Përgjigjen.⁶ Për rrjedhojë, Mbrojtja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme, të cilat

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara, 17 maj 2019, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00570, Mbrojtja e z. Thaçi, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 16 nëntor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2021, F00570/RED.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00583, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 29 nëntor 2021 (njoftuar më 30 nëntor 2021), konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00584, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 1 dhjetor 2021, publik, para. 1, 12.

⁶ Kërkesa për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 2, 10-11.

përbëjnë rrethana të posaçme, që përlligjin shtimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve.⁷

II. DISPOZITATA LIGJORE PËRKATËSE

4. Në bazë të nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, përgjigjet ndaj mocioneve nuk duhet të jenë më shumë se 2.000 fjalë.

5. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës në proces mund të bëjë kërkesë, paraprakisht në kohë të mjaftueshme, për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, nëse tregon se ka arsye të vlefshme për rrethana të posaçme.

6. Në përputhje me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtarë ose mbrojtësit të viktimave, mocioni për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa u dhënë atyre mundësinë për t'u shprehur.

III. DISKUTIM

7. Pasi ka shqyrtuar arsyet e paraqitura nga z. Thaçi, veçanërisht risinë e çështjeve që ngre ZPS-ja dhe sasinë e materialit të cilit Mbrojtja kërkon t'i përgjigjet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë treguar arsye të vlefshme që përlligjin miratimin e ndryshimit të kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve. Po kështu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se Kërkesa për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve është dorëzuar paraprakisht mjaftueshëm në kohë, konkretisht një ditë pas njoftimit të Përgjigjes, si dhe mjaft para afatit të Mbrojtjes për dorëzimin e kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes, që është data 6 dhjetor 2021.

8. Duke mbajtur parasysh se kundërpërgjigjet duhet të trajtojnë vetëm argumentet që përmban Përgjigjja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-ja nuk

⁷ Kërkesa për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 12.

dëmtohet nga nxjerrja e këtij vendimi para marrjes së përgjigjes së saj ndaj Kërkesës për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve.

9. Për pasojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lejon shtimin deri në 6.000 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e Mbrojtjes.

IV. VENDIM

10. Për arsytet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

MIRATON Kërkesën për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve deri në 6.000 fjalë për kundërpërgjigjen e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 1 dhjetor 2021
Në Hagë, Holandë